

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Istogut z. Haki Rugova**

I nderuari z. Rugova,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shprehur që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore 2010. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, ju keni premtuar:

- Angazhim në mirëqenien dhe prosperitetin e qytetarëve;
- Qeverisje të re dhe më efikase;
- Realizimin të gjitha kërkesave të qytetarëve të komunës gjatë mandatit katër vjeçar;
- Vazhdimin e realizimit të projekteve të filluara;
- Infrastrukturë rrugore më të mirë;
- Ndërtim të kanalizimit dhe ujësjellësit;
- Arsim cilësor;
- Investime në bujqësi;
- Shëndetësi më të mire;
- Ekonomi të vogël të zhvilluar;
- Realizimin e shume projekteve për rininë e Istogut;
- Për fshatin Vrellë: sallë sportive në kuadër të shkollës fillore të fshatit, ndriçimin publik, zyre të vendit, çerdhe te re;
- Për fshatin Studenicë: ndërtimin e një objekti të ri shkollor për nxënësit e arsimit fillor;
- Për Banjën: shndërrimin e Banjës në qendër turistike bashkëkohore, asfaltimin e rrugicave nëpër të gjitha lagjet, si dhe objekt të ri shkollor;
- Për fshatin Shushicë: shtrirjen e kanalizimit të ujërave të zeza dhe renovimin objektit shkollor;
- Për fshatin Rakosh: ndërtimin e shkollës së re dhe sallës së kulturës fizike.

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)